



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në
“Bashkinë Pogradec”**

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN TEMETIK

“BASHKIA POGRADEC”

**Auditim Financiar, mbi pasqyrat
financiare 2020**

Tiranë, 2021

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUJVE	FAQE
I	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4 - 6
I.2	Konkluzioni dhe Opinioni Auditmit	6 - 7
II	HYRJA	7 - 12
	a. Titulli. b. Marrësi. c. Objektivat dhe qëllimi. d. Identifikimi i çështjes. e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. f. Përgjegjësitë e Audituesve. g. Kriteret e vlerësimit. h. Standardet e auditimit. i. Metodat e auditimi. j. Dokumenti i auditimit.	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	12 - 22
III/1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12 - 13
III.1.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	13 - 21
	<i>A-Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitet 2019-2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMFE nr.08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme".</i>	
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIMI	21 - 22
VI.	ANEKSET	22 - 48

SHKURTIME

AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NZ	Nëpunës Zbatues
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në përputhje me objektin e auditimit, u auditua me zgjedhje mbi bazë materialiteti dhe risku, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, monitorimi i tyre nga Auditimi i Brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet, mbajtja e kontabilitetit dhe hartimi i pasqyrave financiare, aplikimi i rregullave kontabël si dhe nëse transaksionet financiare janë në përputhje me kërkesat ligjore, rregullat e institucionit dhe parimet, për një qeverisje të mirë dhe transparente, në përmbushje të objektivave të institucionit Bashkia Pogradec.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimet me thesarin duke shkarkuar transaksione financiare nga SIFQ¹, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre duke prekur zonat e llogarive, si më poshtë:

Llogaria 520 “Disponilitete në Thesar”; Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”; Llogaritë 230 dhe 231 “Investime...”; Llogaritë 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, “Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive”; Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”; Llogaria 210 “Toka, troje, terrene”; Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”; Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”; Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”; Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune”; Llogaria 215 “Mjete transporti”; Llogaria 218 “Inventar ekonomik”; Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”; Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”; Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”; Llogaria 4342 “Operacione me shtetin”; Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”; Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”; Llogaria 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”; Llogaria “435 “Sigurime Shoqërore”; Llogaria “436 “Sigurimet shëndetësore”; llogaritja dhe paraqitja e amortizimit, etj.

600 “Paga”, 602 “Shpenzime operative” dhe 230-231 “Investime”.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (balance) të viti 2020, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një *“Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje”*, pasi disa nga llogaritë nuk paraqesin drejt në të gjitha aspektet materiale, pozicionin e llogarive në fund të periudhave ushtrimore, performancës financiare dhe fluksin e parasë në përputhje me kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
1.	Nga auditimi rezultoi se, llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” nuk paraqet gjendjen reale, sepse nuk disponohet asnjë lloj dokumenti pronësie për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale, të mbartura nga periudhat raportuese para vitit 2015. Këto ndërtesa e konstruksione nuk janë të shoqëruara me kartela, nuk			Titullari i Bashkisë Pogradec të marrë masa nëpërmjet strukturave për të përgatitur dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin e tyre në AKSH, ndërsa Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

¹ Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	evidentohet viti i ndërtimit dhe vlera e tyre. Në disa objekte vlera historike pasqyrohet me 0 (zero), njëkohësisht ndërmjet të dhënave të kontabilitetit të administruar nga Drejtoria e Financës, me të dhënat që evidenton DPZHT ka mospërputhje, ku disa objekte ndërtesa nuk pasqyrohen në kontabilitet, për të cilën kërkohet sistemim i menjëhershëm dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Këto veprime janë në mospërputhje me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimi hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi pasurive dhe regjistrimi pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, pika 35			
2.	a) Nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se Bashkia Pogradec në datën 20.06.2000 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të U.... Pogradec SHA me NUIS “J....”, e cila është shoqëri aksionare me objekt shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, etj. Numri i aksioneve është 672,859.00 me vlerë nominale 1,000.00 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 672,859,000.00 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pogradec në “U.... Pogradec” SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.			Nga Bashkia Pogradec, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “U.... Pogradec” sha me vlerë kontabël 672,859,000.00 lekë dhe të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “P.....K.” sha me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca në Raport	Rekomandimi
	b) Nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se Bashkia Pogradec në datën 13.09.2011 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të P.....K. SHA, me NUIS “M....” e cila është shoqëri aksionare me objekt organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit, etj. Numri i aksioneve është 350.00 me vlerë nominale 10.000,00 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,500,000.00 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pogradec në “P.....K.” SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”. Këto veprime/mosveprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Në rastin tonë investimet përbëjnë aksionet me vlerë kontabël (kosto) 676,359,000 lekë dhe investitori është Bashkia Pogradec. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivët Afatgjata Financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 676,359,000 lekë përbën deformim të informacionit financiar			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Pogradec, për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje²:

Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Pogradec paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Bashkia Pogradec në datën 31.12.2020 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar.

Baza për opinionin e pakualifikuar, me theksim çështjeje:

- Mos pasqyrimi në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në llogarinë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” i Aktiveve Afatgjata Financiare, të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 676,359,000 lekë (“*U.... Pogradec*” Sha në vlerën 672,859,000 lekë dhe “*P.....K.*” Sha në vlerën 3,500,000.00 lekë) përbën deformim të informacionit financiar.
- Nga auditimi u konstatua se llogaria 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” nuk paraqet gjendjen reale sepse, nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale, të mbartura nga periudhat raportuese para vitit 2015. Këto ndërtesa e konstruksione nuk janë të shoqëruara me kartela, nuk evidentohet viti i ndërtimit dhe vlera e tyre. Në disa objekte vlera historike pasqyrohet me 0 (zero), njëkohësisht ndërmjet të dhënave të kontabilitetit të administruar nga Drejtoria e Financës, me të dhënat që evidenton DPZHT ka mospërputhje, ku disa objekte ndërtesa nuk pasqyrohen në kontabilitet, për të cilën kërkohet sistemimi i menjëhershëm dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Theksimi i çështjeje:

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Pogradec, sa i takon llogarive të mëposhtme:

- Llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”
- Llogaria 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Pogradec:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Pogradec janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

² **Opinion i pamodifikuar me theksim çështjeje.** Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si “theksimi i çështjes” përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit.

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

II/1. PËRSHKRIM I AUDITIMIT.

Mbështetur në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 678, datë 14.06.2021 dhe autorizimit nr. 678/6, datë 14.6.2021 “*Mbi auditimin e pasqyrave financiare viti 2020*”, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 14.06.2021 – 02.07.2021, në subjektin Bashkia Pogradec për periudhën e veprimtarisë nga 01.07.2019 – 31.12.2020, u krye auditimi “*Auditim Financiar dhe Përputhshmëri*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. **K. GJ**, Përgjegjës Grupi
2. **J. P**, Auditues

a- Titulli: Auditim financiar në Bashkinë Pogradec.

b- Marrësi: Raporti i Auditimit Tematik i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Pogradec.

c- Objektivat dhe qëllimi: Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2020, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet e përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar. Audituesit shtetërorë do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

d- Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësive vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Pogradec, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Pogradec.

e- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Administratori i Përgjithshëm, në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) I. XH., Kryetar i Bashkisë Pogradec dhe Drejtore e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ) I. K., janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Pogradec, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34, pika 6³, neni 65, pika 1⁴ dhe neni 91, pika 1.3⁵.

f- Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Pogradec dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

Parimet e auditimit financiar: Në punën tonë audituese jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

- *Etika dhe pavarësia;*
- *Kontrolli i cilësisë*
- *Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*
- *Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

³ Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore

⁴ Në njësitë administrative funksionon administrata që drejtohet nga administratori.

⁵ Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre;

ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:

- *Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme
- *Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël
- *Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura
- *Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

- *Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë
- *Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit
- *Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar
- *Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

- *Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
- *Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
- *Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.
- *Saktësia dhe vlerësimi:* Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

g- Kriteret e vlerësimit: Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.15, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit sa më poshtë:

▪ **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:**
Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

h- Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-

2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.; Kodit Etik dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

i- Metodatat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin⁶.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerësojnë si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)
- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktonte nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

⁶ **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajton përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- Kontrolli sipas një treguesi. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
- **Intervista**
- **Raporte dhe Informacione**
- **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

j- Dokumentimi i auditimit: Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231). Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrolleve është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja⁷.

Procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në kundërshtitë, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

III/1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Zona Gjeografike: Pogradeci kufizohet në veri me bashkinë Përrenjas, në perëndim me bashkinë Gramsh, në jug me bashkinë Maliq, në juglindje me bashkinë Pustec, ndërsa në lindje me Republikën e Maqedonisë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Pogradecit.

⁷ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 61.530 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 90.976 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 548.77 km².

Të dhëna të tjera: Bashkia e Pogradecit do të bashkojë në një të vetme të gjitha njësitet e rrethit të deritanishëm të Pogradecit duke ruajtur të njëjtët kufij territorialë që ka pasur deri tani rrethi. Qytetit të Pogradecit dhe komunave Udenisht e Buçimas që shtrihen përgjatë Liqenit të Ohrit dhe orientohen drejt turizmit, me ndarjen e re territoriale i bashkohen dhe disa zona të thella malore, të cilat përballen me varfërinë dhe mungesën e punësimit.

Për shumë familje kryesisht nga fshatrat përreth Pogradecit, vendi fqinj i Maqedonisë është zgjidhja për punësim ditor ose sezonal. Burrat shkojnë për të punuar në vendin fqinjë kryesisht në sektorin e ndërtimit dhe punëve të tjera të krahut.

Asetet kulturore në zonë janë të shumta por pak të njohura pasi deri më tani kanë munguar politikat e promovimit. Pavarësisht fshatrave të shumta turistike buzë liqenit, turistët që vijnë janë të orientuar nga agjencitë turistike maqedonase të cilat përfshijnë në paketat turistike që ofrojnë vizitat ditore në Pogradec dhe disa nga fshatrat si Lin, Tushemisht, Volorekë, etj.

Pogradeci dhe fshatrat pranë tij, për shkak se janë kthyer në një destinacion turistik, kanë pasur



një hov të sektorit të ndërtimit ku përgjatë dekadës së fundit janë ngritur dhjetra pallate shumëkatësh, duke ngritur shumë pikëpyetje lidhur me planifikimin urbanistik të zonës.

Njësitet Administrative dhe fshatrat e Pogradecit:

Emri i Njesisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
Pogradec	Qyteti Pogradec
Udenisht	Fshatrat; Udenisht, Memlisht, Çervenakë, Piskupat, Lin, Bugez
Buçimas	Fshatrat; Buçimas, Tushemisht, Peshkëpi, Gurras, Gështënjës, Remenj, Vërdovë, Bahçallëk
Çërravë	Fshatrat; Çërravë, Blacë, Bletas, Alarup, Pretushë, Grabovicë, Nizhavec, Kodras, Leshnicë, Lumas, Qershizë
Dardhas	Fshatrat; Dardhas, Stropckë, Grunjas, Prenisht, Dërdushë, Osnat, Lekas, Nicë, Stërkanj
Trebinjë	Fshatrat; Trebinjë, Çezmë e Madhe, Çezmë e Vogël, Hondisht, Selcë e Sipërme, Llëngë, Plenisht, Hoshtecë, Zemcë, Potgozhan, Malinë, Kalivaç, Pevelan, Dunicë, Guri i Bardhë
Proptisht	Fshatrat; Proptisht, Rodokal Sipër, Rodokal Poshtë, Homezh, Slabinjë, Somotinë, Kriçkovë, Selcë e Poshtme, Homçan, Vërri, Golik, Slatinë, Baribardhë, Selishtë, Zalltore
Velçan	Fshatrat; Velçan, Buzahishtë, Shpellë, Bishnicë, Jollë, Losnik, Laktesh, Senishtë

Kryetar i Bashkisë Pogradec është I. XH., i zgjedhur në vitin 2019.

Këshilli Bashkiak i Bashkisë Pogradec përbëhet nga 31 anëtarë.

▪ **Ndikimi i pandemisë COVID-19 në jetën ekonomike**

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga Bashkia Pogradec që në fillim të vitit 2020 janë planifikuar shpenzime për emergjencat në shumën 17,500,000 lek. Nga këto janë shpenzuar 5,550,000 lek, të cilat përfshijnë blerje dezinfektantësh, blerje materiale pastrimi dhe blerje për nevoja ushqimore. Krahas planifikimit me fondet e veta, ka pasur një sponsorizime nga UNDP në shumën 2,500 Euro për familjet Rome dhe Egjiptiane.

III/2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr.08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Nga auditimi Financiar i ushtruar në Bashkinë Pogradec për Pasqyrat Financiare të vitit 2020, u konstatua se:

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit:

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë elektronike me sistemin alfa buxhetor për hedhjen e veprimeve me bankën, arkën, magazinën, kontabilizimin e veprimeve të ndryshme etj.

Nxjerrja e pasqyrave financiare:

Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Pogradec me shkresën nr. 996 prot., datë 26.02.2021, të përbëra si vijon:

- Formati nr. 1: Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2: Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3: Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow).
- Formati nr. 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5: Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6: Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata me koston historike.
- Formati nr. 7/b: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata me vlerën neto).
- Formati nr. 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit:

Llogaritë 520, 466 dhe llogaritë e të ardhurave

Testimi i llogarisë 520: Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën debitorë 183,691,558 lekë.

Edhe referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Pogradec, kjo llogari është për të njëjtën vlerë, 183,691,558 lekë.

Sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, analiza e kësaj llogarie është si vijon:

- 41,613,258 lekë të trashëguara nga viti 2019, kurse për vitin 2020, janë 34,172,488 lekë nga të cilat 33,153,707 lekë janë ngurtësime për garanci të punimeve me sipërmarrje dhe 1,018,781 lekë janë pulla poste;
- 1,604,000,451 lekë hyrje gjatë vitit ushtrimor nga të cilat 445,562,986 lekë janë grande të pakushtëzuara dhe 143,651,654 lekë janë grande të kushtëzuara;

- 1,655,983,612 lekë janë shpenzime buxhetore, nga të cilat 276,373,115 lekë janë shpenzime për investime.

Testimi i llogarisë 466: Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 34,172,488 lekë. Sipas analizës, kjo llogari e rakorduar me degën e thesarit, është për vlerën 33,153,707 lekë për garanci të punimeve dhe 1,018,781 lekë janë pulla poste.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet për vitin 2020 investimet të cilat përbëjnë vlerën më të madhe të ngurtësimit janë 7 objekte (investime te reja) dhe 13 objekte të cilat kanë përfunduar nga viti i kaluar.

Nga auditimi mbi procedurat e zbatuara për ngurtësimin e fondeve si garanci për cilësinë e punimeve të kryera nga subjektet sipërmarrëse, u konstatua se janë zbatuar kërkesat ligjore.

Konkretisht, gjatë vitit 2020, llogaria 466 është shtuar në vlerën **13,820,740 lekë** për investime të kryera në disa objekte.

Nga ditari i bankës, konstatohet se janë kontabilizuar në kredi të llogarisë 466 vlera totale për disa objekte, si më poshtë:

1. Sistemim blloku ish-Ferma	305,845 lekë
2. Sistemim asfaltim blloku Rruga e Kabashit	1,084,710 lekë
3. Sistemim Blloku 5 Segmenti, Jani Basho	214,215 lekë
4. Ndërtim Ura dhe Rruga Zalli i Tores	506,403 lekë
5. Përforsim banesa	914,985 lekë
6. Ndërtim Ujësjiellësi Udënisht-Memlisht	5,641,564 lekë
7. Mbulimi me rrjet Kanalizimi në fsh. Guras	738,700 lekë
8. Rehabilitimi i shk. Mesme M. Çollaku	933,233 lekë
Totali:	10,339,655 lekë

Testimi i llogarive 230 dhe 231: Llogaritë 230 dhe 231 “Investime në proces”, ku nga auditimi u konstatuan 16 raste për vlerën 276,373,115 lekë, të cilat janë investime të kryera gjatë vitit ushtrimor 2020, investime të cilat janë kapitalizuar dhe transferuar tek ndërmarrjet e varësisë, (sipas Urdhër Shpenzimeve përkatës).

Sipas bilancit, vlera e llogarisë 230 është 2,415,109 lekë. Për vitin 2020, ka kaluar vlera e një projekti, i cili ka shtrirje për t’u likuiduar deri në vitin 2023. Për këtë shkak nuk është kapitalizuar.

Vlera prej 7,944,548 lekë e llogarisë 231 në kontabilitet, është vlera e mbetur nga ish-komunat, e pa kapitalizuar, si dhe disa investime të papërfunduara, të likuiduara për vitin 2020, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Rehabilitim/Sistemim i rrugicave tek lagjja “Kalaja”	2,235,938
2	Shtese fondi tek obj. “Sistemim Blloku tek ish Ferma Loti i parë”	6,386,954
3	Rikonstrukcion i trotuareve Rr. Rinia +Voluta+Mulla Kurti	2,297,244
4	Rehabilitim/perforcim banesash ekzistuese	19,678,974
5	Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te Rruga e Mokrës	6,262,873
6	Sistemim asfaltim rrugësh blloku i banimit te Rruga e Kabashit	22,894,434
7	Sistemim Blloku Nr. 5, (Segmenti Jani Basho)	4,284,307
8	Ndërtim Ura dhe rruga Zall i Torres, NJ. A. Proptisht	10,128,072
9	Regjistrimi tokave Blace+Kalivac+Proptisht, Piskupat	2,074,800
10	Ndërtimi i Ujësjiellësit Udënisht-Mëmëlisht,Pogradec (2020)	114,492,125
11	Mbulimi me rjet Kanalizimi për fshatin e Gurasit dhe zona e Dilonit	15,095,682
12	Mbikq. Linja e jashtë. e ujësji. “Uji i Zi -Dalja Tuneli”Bishnicë	
13	Rehabilitimi i shkollës së Mesme Gjergj Pekmezi	45,571,438
14	Rehabilitimi i shkollës së Mesme Muharrem Çollaku	19,094,476

Nr.	Emërtimi	Vlera
15	Rehabilitim i shkollës 9 vjeçare “Sami Zgjani” Guras	5,509,968
16	Kol. “Rikonst. Objekte dhe terr. spor. Shk. 9 vjeçare “Kozma Basho”	93,116
Totali:		276,373,115

Testimi i Pasqyrës së Performancës Financiare

Të ardhurat nga tatim taksat dhe tarifat lokale për vitin 2020, sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, janë në shumën 307,157,414 lekë.

Kjo shumë, është pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2020, në Formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare”, nga të cilat:

- të ardhura nga taksat dhe tatimet: 163,100,682 lekë
- të ardhura jo tatimore 109,736,219 lekë
- taksë përdorimi automjete dhe taksë mbi të ardhurat personale 32,104,489 lekë
- renta minerare 446,425 lekë
- sponsorizime 738,000 lekë
- grante te huaja 1,031,597 lekë

Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë: 202, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32

Për vitin 2020 janë ngritur Urdhurat si më poshtë:

1. Urdhër nr. 891 dt. 05.11.2020 “Për krijimin e komisionit të inventarizimit të Aktiveve Afatshkurtra dhe Afatgjata në Bashki dhe NJ.A.”
2. Urdhër nr. 892 dt. 05.11.2020 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit në NJ.A. Proptisht”.
3. Urdhër nr. 893 dt. 05.11.2020 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit në NJ.A. Velçan”.
4. Urdhër nr. 894 dt. 05.11.2020 “Për krijimin e komisionit të vlerësimit dhe inventarizimit në NJ.A. Trebinjë”.
5. Urdhër nr. 895 dt. 05.11.2020 “Për krijimin e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit të Aktiveve Afatshkurtra dhe Afatgjata në Bashki dhe NJ.A.”
6. Urdhër nr. 896 dt. 05.11.2020 “Për krijimin e komisionit të asgjësimit të Aktiveve Afatshkurtra dhe Afatgjata në Bashki dhe NJ.A.”

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, kjo llogari për vitin 2020, pasqyron gjendje debitorë në vlerën 6,865,947 lekë,
- Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” për vlerën kontabël dhe historike 5,163,520 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për 2,074,800 lekë. Te kjo llogari është shtuar regjistrimi i tokës Blacë. (Analiza e llogarisë 210 është paraqitur hollësisht në Anekset bashkëlidhur, Pasqyra nr. 4)
- Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione” paraqitet në shumën 23,737,562 lekë. Gjatë vitit në këtë llogari nuk ka shtesa.

1. Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e administrimin e Aktiveve Afatgjata Materiale llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”, pa titull pronësie.

Situata:

Nga auditimi rezultoi se llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” për vitin 2020 është në vlerën historike për 65,013,022 lekë, e cila rezulton duke zbritur nga shuma totale prej 182,420,751 lekë normën e amortizimit të akumuluar në vlerën 117,407,729 lekë. Gjatë vitit 2020 janë shtuar

95,034,243 lekë ndërtesa shkollore, investime të cilat janë transferuar tek Sektori i Arsimit dhe 18,299,716 lekë për rehabilitim banesash, investime të cilat janë transferuar te individët. Nga auditimi u konstatua se llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” nuk paraqet gjendjen reale sepse, nuk disponohet asnjë lloj dokument pronësie për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale, të mbartura nga periudhat raportuese para vitit 2015. Këto ndërtesa e konstruksione nuk janë të shoqëruara me kartela, nuk evidentohet viti i ndërtimit dhe vlera e tyre. Në disa objekte vlera historike pasqyrohet me 0 (zero), njëkohësisht ndërmjet të dhënave të kontabilitetit të administruar nga Drejtoria e Financës, me të dhënat që evidenton DPZHT ka mospërputhje, ku disa objekte ndërtesa nuk pasqyrohen në kontabilitet, për të cilën kërkohet sistemimi i menjëhershëm dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse.

Kriteri:

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimi hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi pasurive dhe regjistrimi pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, pika 35.

Ndikimi/Efekti:

Pengesë në kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme; pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre; mos kontabilizimin e tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare.

Shkaku:

Dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga NJSH (ish-Komunat); vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë; kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim:

Titullari i Bashkisë Pogradec të marrë masa nëpërmjet strukturave për të përgatitur dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin e tyre në AKSH, ndërsa Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

- Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” për vlerën historike 816,774,559 lekë, rezulton duke zbritur nga shuma totale prej 1,057,629,320 lekë normën e amortizimit të akumuluar në vlerën 240,854,761 lekë. Gjatë vitit 2020 janë shtuar 55,006,200 lekë rikonstruksion rrugësh, nga të cilat 44,878,128 lekë investime të cilat janë transferuar tek Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike, rikonstruksion të urave 862,880 lekë, transferuar tek NMIPP, rikonstruksion të rrjeteve 129,860,521 lekë, shtuar investim gjatë vitit “Ndërtim Ujësjiellësi Udënisht-Mëmlisht” në vlerën 114,492,125 lekë dhe “Mbulim me rrjet Kanalizimi për fshatin e Gurasit dhe zona e Drilonit” në vlerën 15,095,682 lekë.

(Analiza e llogarisë 213 është paraqitur hollësisht në Anekset bashkëlidhur, Pasqyra nr. 7)

- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune” për vlerën kontabël dhe historike 9,451,134 lekë, e cila rezulton duke zbritur nga shuma totale prej 22,612,591 lekë normën e amortizimit të akumuluar në vlerën 13,161,457 lekë. Gjatë vitit kjo llogari nuk ka pasur ndryshime në rritje ose zvogëlim të vlerës.

(Analiza e llogarisë 214 është paraqitur hollësisht në Anekset bashkëlidhur, Pasqyra nr. 8)

- Llogaria 215 “Mjete transporti” për vlerën historike 15,154,348 lekë, e cila gjatë vitit ushtrimor nuk ka pasur ndryshime në rritje ose zvogëlim të vlerës. Në bilanc është shuma

452,543 lek e cila përbëhet nga diferenca e vlerës fillestare të mjeteve të transportit prej 15,154,348 lekë, me vlerën e amortizimit të akumuluar prej 14,701,805 lekë.

(Analiza e llogarisë 215 është paraqitur hollësisht në Anekset bashkëlidhur, Pasqyra nr. 9)

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën historike **9,498,000 lekë**, e cila rezulton duke zbritur nga shuma totale prej **25,432,921 lekë** normën e amortizimit të akumuluar në vlerën **15,934,921 lekë**, është sipas rezultatit të inventarizimit fizik. Gjatë vitit kjo llogari ka pasur ndryshime në rritje për vlerën 4,832,216 lekë, dhuruar nga ADISA, pajisje kompjuterike dhe zyre.

2. Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e Aktiveve Afatgjata Financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2020.
--

Situata:

Llogaritë e Klasës 25/26 “Aktivet Afatgjata Financiare”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2020, vlera kontabël paraqitet në shumën 300,000 lekë.

1. Bashkia Pogradec nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se në datën 20.06.2000 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të U.... Pogradec SHA me NUIS “J....”, e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. b.Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm c. Prodhimi dhe /ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve ç. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura. d. Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre. 2.Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. 3 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 672,859.00 me vlerë nominale 1,000.00 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 672,859,000.00 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pogradec në “U.... Pogradec” SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

2. Bashkia Pogradec nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se në datën 13.09.2011 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të P.....K. SHA, me NUIS “M....” e cila është shoqëri aksionare me objekt “- Organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit të futbollit dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga Federata Sportive e Futbollit, si dhe pjesëmarrjen në garat sportive të organizuara nga UEFA. -Krijimin e ekipeve zinxhir të futbollit. -Kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë duke përfshirë lëshimin e dorëzanive e garancive të tjera. –Përfaqësimin e shoqërive të ndryshme shqiptare apo të huaja që kanë objekt të njëjtë apo të përafërt me të kësaj shoqërie”. Numri i aksioneve është 350.00 me vlerë nominale 10.000,00 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,500,000.00 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pogradec në “P.....K.” SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

Këto veprime/mosveprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo

materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”.

Në rastin tonë investimet përbëjnë aksionet me vlerë kontabël (kosto) 676,359,000 lekë dhe investitori është Bashkia Pogradec.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 676,359,000 lekë përbën deformim të informacionit financiar.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: Ligji nr. 9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, Urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “*Aktivët Afatgjatë Materiale dhe Aktivët Afatgjatë Jo materiale*” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “*Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje*”

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2018 dhe 2019 të llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 “*Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar*”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “*Aktivët Afatgjatë Materiale dhe Aktivët Afatgjatë Jo materiale*” dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “*Investime në Pjesëmarrje*”.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim:

Nga Drejtori Ekonomik në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “*U.... Pogradec*” sha me vlerë kontabël 672,859,000.00 lekë dhe të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “*P.....K.*” sha me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

- Llogaria 31 “*Materiale*” për vlerën kontabël 1,217,878 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor për 15,562,267 lekë dhe pakësuar në vlerën 15,344,389 = 1,217,878lekë.

- Llogaria 32 “*Inventar i imët*” për vlerën kontabël 8,141,914 lekë, shtuar gjatë vitit ushtrimor në vlerën 1,371,400 lekë.

Analiza e llogarive debitorë

Gjendja e llogarive debitorë në llogaritë financiare të vitit 2020:

- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*”, paraqitet me vlerë kontabël 116,512,222 lekë. Kjo llogari krahasuar me vitin paraardhës është pakësuar për vlerën (116,789,922 - 116,512,222) lekë = 277,700 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se në debi të saj janë kontabilizuar debitorët me analizë si vijon:

- | | |
|--|------------------|
| - detyrime për tatim taksat lokale | 2,258,100 lekë, |
| - detyrime të pa arkëtuara sipas rekomandimeve të KLSH-së | 55,796,717 lekë, |
| - detyrime të pa arkëtuara sipas rekomandimeve të KLSH-së, për kontrata qiraje | 17,348,598 lekë, |
| - detyrime të pa arkëtuara nga detyrimet e ish-komunave | 27,394,901 lekë, |
| - gjopa të vendosura nga IKMT por të pa arkëtuara | 10,188,206 lekë, |
| - detyrime për tërheqjen e pullave të Gjendjeve Civile | 3,099,000 lekë, |

- detyrime për tërheqjen e blloqeve të letrave me vlerë 426,700 lekë.
(Analiza e llogarisë 468 është paraqitur hollësisht në Aneksat bashkëlidhur, Pasqyra nr. 11)

Debitorët e taksave e tarifave vendore dhe gjobat e IMT

Nga të dhënat analitike të kësaj llogarie, konstatohet se janë kontabilizuar debitorë gjithsej për 263 subjekte dhe persona fizikë. Ka debitorë nga viti 2010 kurse debitorët për tatim taksat janë që nga viti 2013.

Me shkresën nr. 63 dt 17.03.2021, në Drejtorinë e Financës janë dorëzuar listat e debitorëve dhe taksave e tarifave vendore të cilët ndahen:

- 7622 familjarë në shumën 36,385,968 lekë;
- 30 biznese të mëdha në shumën 60,359,568 lekë;
- 253 biznese të vogla në shumën 47,129,932 lekë.

Debitorët nga taksat dhe tarifat nuk janë paraqitur në Bilancin e vitit 2020.

Gjobat e IMT nuk janë paraqitur dhe dokumentuar në Drejtorinë e Financës për vitin 2020. Akt konstatimet dhe gjobat e vendosura gjatë vitit 2020 nuk janë pasqyruar dhe kontabilizuar. Në Drejtorinë e Financës nuk janë paraqitur informacione shkresore nga strukturat përkatëse, të cilat duhet të paraqesin gjobat për t'u kontabilizuar si debitorë brenda një periudhe 1 muajore, nëse ato nuk paguhen menjëherë nga gjobëmarrësi. Nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, shkresat janë dorëzuar dhe protokolluar më 10.02.2021 dhe për rrjedhojë janë kontabilizuar në vitin 2021.

Testimi i llogarive 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe 4342 “Operacione me shtetin”.

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në bilanc për vlerën kontabël 305,214,008 lekë.

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin” për vlerën kontabël 25,261,649 lekë.

Në Bilancin e vitit 2020 llogaria debitorë 4342 është 44,367,090 lekë, e cila përbëhet nga shuma e financimit të pritshëm për paga, tatim mbi pagën dhe sigurime shoqërore e shëndetësore në vlerën 19,105,441 lekë dhe vlera e detyrimeve pa dokumentacion justifikues në vlerën 25,261,649 lekë.

Këto llogari përfaqësojnë vlerën kundërparti të disa llogarive të detyrimeve kreditore të pasivit të bilancit, e analizuar si vijon:

- 302,088,168 lekë, detyrime me kundërparti në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”,
- 28,088,168 lekë detyrime ndaj furnitorëve me kundërparti llogarinë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”.

Referuar Bilancit kontabël Dhjetor 2020, debiti i llogarisë 486, është analizuar si vijon:

Nr.	Emërtimi	Shtesa	Vlera 2019	Likuiduar 2020	Gjendja më 30.12.2020
1	Detyrime të prapambetura për Vendime Gjyqësore	908249	118,877,527	7,000,779	112,784,997
2	Detyrime të prapambetura për shërbime		103,887,578	9,824,554	94,063,024
3	Detyrime të prapambetura për mirëmbajtje		601,529		601,529
4	Detyrime të prapambetura për Blerje		11,000,782	1,606,940	9,393,842
5	Detyrime të prapambetura për Investime		82,016,486	6,470,630	75,545,856
	Totali	908249	316,383,903	24,902,903	292,389,248
6	Detyrime të prapambetura për të tjera, pa dokumentacion justifikues	990,867	38,556,103	1,460,560	38,086,410
	Totali	1,899,116	354,940,006	26,363,463	330,475,658

Përsa i përket detyrimeve të prapambetura, Bashkia Pogradec trashëgon borxh të madh nga vitet e mëparshme, kryesisht nga ish-komunat. Te Pasqyra nr. 12 në Aneksa, janë paraqitur detyrimet sipas ndarjes klasore deri në Dhjetor 2020. Bashkëlidhur është lista e debitorëve të

Bashkisë gjatë viteve. Bashkia ka bërë planifikimin në Buxhetin e vitit 2020 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në shumën 50,000,000 lekë, të cilat shpërndahen sipas listës së debitorëve. Për shkak të pamundësisë financiare, planifikimi është shumë i vogël krahasuar me totalin e borxhit.

Analiza e llogarive kreditore

- Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” është për vlerën kontabël 28,088,168 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se Bashkia Pogradec në fund të vitit 2020, rezulton me detyrime të prapambetura, për shumën 28,088,168 lekë. Këto detyrime janë krijuar para vitit 2015 (përfshirë detyrimet e shtuara nga ish-komunat). Në vitet më pas nuk ka detyrime të prapambetura, kurse detyrimet e muajit Dhjetor 2020 në shumën 990,867 lekë, janë likuiduar gjatë 4-mujorit të I të vitit 2021.

- Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”. Nga analiza, konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar detyrimet për vlerën totale 302,387,489 lekë.

Kjo llogari rezulton me detyrime të prapambetura, para vitit 2015 (përfshi dhe detyrimet e shtuara nga ish-komunat), e analizuar si më poshtë:

- detyrime për “*vendime gjyqësore*”, në vlerën 112,784,997 lekë
- detyrime për shërbime pastrimi, poste, komisione bankare etj., 91,288,685 lekë
- detyrime KESH (para vitit 2015), pa fatura bashkëlidhur, 22,767,951 lekë
- detyrime për investime 75,545,856 lekë
(nga të cilat vlera 26,780,147 lekë nga ish-komunat).
- Llogaria 42 “*Detyrime ndaj personelit*” për vlerën 13,770,277 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin pagave të muajit dhjetor 2020. (Nga 12,748,693 lekë në vitin paraardhës).

- Llogaria 431 “*Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat*” për vlerën 1,048,014 lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për tatimin mbi të ardhurat personale. (Nga 994,170 lekë në vitin paraardhës).

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2020.

- Llogaria “435 “*Sigurime Shoqërore*” për vlerën 3,770,138 lekë përfaqëson detyrimet e pa paguara për sigurimet shoqërore. (Nga 3,383,468 lekë në vitin paraardhës).

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor 2020.

- Llogaria “436 “*Sigurimet shëndetësore*” për vlerën e detyrimeve 517,012 lekë (Nga 464,063 lekë në vitin paraardhës).

Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se këto detyrime i përkasin sigurimeve shëndetësore për muajin dhjetor 2020.

Shpenzimet për paga dhe shpenzimet operative

- Shpenzimet për llogarinë 600 “*Paga dhe shpërblime të tjera personeli*” në vlerën 153,361 mijë lek përbëjnë rreth 40% të totalit të shpenzimeve.
- Shpenzimet për llogarinë 601 “*Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*” në vlerën 24,836 mijë lek përbëjnë rreth 5% të totalit të shpenzimeve.
Në ndryshim nga viti paraardhës, fondi i planifikuar për paga ka qenë 160,000 lekë dhe janë shpenzuar 122,073 mijë lekë.
- Artikulli 602, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë realizuar në masën 66%. Janë likuiduar pjesërisht detyrimet e trashëguara nga viti 2019, për të cilat ka pasur fonde por nuk janë likuiduar plotësisht për shkak të limitit të vendosur në thesar, janë shlyer rregullisht detyrimet ndaj të tretëve si ndaj OSHEE, Ujesjelles kanalizimeve, shpenzimet telefonike

dhe interneti. Janë kryer rregullisht pagesat e këshilltareve dhe kryetareve të fshatrave sipas listeprezencave të paraqitura.

- Shpenzimet për llogarinë 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*” në vlerën 81,657 mijë lekë përben rreth 25% të totalit të shpenzimeve.
- Shpenzimet për llogarinë 603, 604 “*Subvencione*” në vlerën 30,967 mijë lekë përbëjnë rreth 10% të totalit të shpenzimeve.

Amortizimi

Sipas UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 36, në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata, llogaritja është bërë sipas normave të përcaktuara në këtë ligj, të pasqyruara në Formatin nr. 7/b “*Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata*” (vlera neto), ku vlera e amortizimit vjetor është 41,617,114 lekë, kurse amortizimi i akumuluar 402,060,673 lekë, të paraqitura si më poshtë:

2192	Amortizim ndërtesa	117,407,729 lekë
2193	Amortizim rrugë, ura	240,854,761 lekë
2194	Amortizim makineri e paisje	13,161,457 lekë
2195	Amortizim mjete transporti	14,701,805 lekë
2198	Amortizim inventar ekonomik	15,934,921 lekë

Nga tabela e amortizimit vjetor, të Llogaria 215 “*Mjete transporti*”, norma e amortizimit progresiv është në vlerën 14,701,805 lekë, kurse vlera totale sipas kostos historike është 15,154,348 lekë. Diferenca prej 452,543 lekë, përbëhet nga 16 mjete transporti të viteve të hershme, të cilat janë me vlera të vogla për shkak të amortizimit kontabël, por që janë në gjendje pune.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, llogaria 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” nuk paraqet gjendjen reale, sepse nuk disponohet asnjë lloj dokumenti pronësie për objektet e trashëguara nga njësitë vendore që u shkrinë me reformën territoriale, të mbartura nga periudhat raportuese para vitit 2015. Këto ndërtesa e konstruksione nuk janë të shoqëruara me kartela, nuk evidentohet viti i ndërtimit dhe vlera e tyre. Në disa objekte vlera historike pasqyrohet me 0 (zero), njëkohësisht ndërmjet të dhënave të kontabilitetit të administruar nga Drejtoria e Financës, me të dhënat që evidenton DPZHT ka mospërputhje, ku disa objekte ndërtesa nuk pasqyrohen në kontabilitet, për të cilën kërkohet sistemim i menjëhershëm dhe kalimi në administrim në llogarinë përkatëse. Këto veprime janë në mospërputhje me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimi hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, Kreu VI, “*Transferimi pasurive dhe regjistrimi pasurive të paluajtshme*”, pika 1 dhe 2. Kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, Kreu III, pika 35.

1.1. Rekomandim: Titullari i Bashkisë Pogradec të marrë masa nëpërmjet strukturave për të përgatitur dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin e tyre në AKSH, ndërsa Drejtoria e Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit, burimet e financimit me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Deri në mbylljen e PF të vitit 2021.

2. Gjetje nga auditimi: a) Nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se Bashkia Pogradec në datën 20.06.2000 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të U.... Pogradec SHA me NUIS "J....", e cila është shoqëri aksionare me objekt shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, etj. Numri i aksioneve është 672,859.00 me vlerë nominale 1,000.00 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 672,859,000.00 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pogradec në "U.... Pogradec" SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".

b) Nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se Bashkia Pogradec në datën 13.09.2011 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të P.....K. SHA, me NUIS "M...." e cila është shoqëri aksionare me objekt organizimin e aktiviteteve në fushën e sportit, etj. Numri i aksioneve është 350.00 me vlerë nominale 10,000.00 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 3,500,000.00 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Pogradec në "P.....K." SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet".

Këto veprime/mosveprime janë në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 "Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar" me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale" pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 "Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje".

Në rastin tonë investimet përbëjnë aksionet me vlerë kontabël (kosto) 676,359,000 lekë dhe investitori është Bashkia Pogradec.

Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivët Afatgjata Financiare të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 676,359,000 lekë përbën deformim të informacionit financiar (Trajtuar gjerësisht në akt konstatimin nr. 6, datë 02.07.2021)

2.2. Rekomandim: Nga Bashkia Pogradec, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "U.... Pogradec" sha me vlerë kontabël 672,859,000.00 lekë dhe të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të "P.....K." sha me vlerë 3,500,000 lekë, në debi të llogarisë 26 "Pjesëmarrje në kapitalin e vet" dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Deri në mbylljen e PF të vitit 2021.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi Tematik.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

